



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:032355

Datë: 18.10.2022

Numri i dokumentit: 03541022

C.nr.101/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Vushtrri – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni për Çështje Civile, me gjyqtarin Naim Rekalju, në çështjen juridike kontestimore të paditësve I.I., R. B. dhe N. M. të gjithë nga V., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av.Lutfi Tahiri me seli të zyrës në Prishtinë, kundër të paditurës K. e V.-D. për A., lidhur me kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë, vlera e kontestit 750.00 euro, jashtë seancës me datë 18.10.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësve I.I., R. B. dhe N. M. të gjithë nga V.dhe DETYROHET e paditura K. e V.-D. për A., që në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën 01.09.2019 e deri me datë 11.03.2020 t’ua paguaj shumat si në vijim;

-Paditësit I. I., shumën prej 250.00 euro,

-Paditëses R. B, shumën prej 250.00 euro, dhe

-Paditëses N. M, shumën prej 250.00 euro.

Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data e pranimit të aktgjykimit, e deri në pagesën definitive, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

II. DETYROHET e paditura K. e V.-D. për A., që paditësve t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës, dhe atë për padi shumën prej 208.00 euro dhe për taksën gjyqësore për padi shumën

prej 20.00 euro, apo shumën e përgjithshme prej 228.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e këtë nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësit I.I., R. B. dhe N. M. të gjithë nga V, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av.Lutfi Tahiri me seli të zyrës në Prishtinë, pranë kësaj gjykate kanë paraqitur padi me datë 19.02.2021, me të cilën kanë kërkuar që të obligohet e paditura që të u'a kompensoj shpenzimet e ushqimit për periudhën nga data 01.09.2019 e deri me datë 11.03.2020 dhe atë në shumë të përgjithshme prej 750,00 euro (për secilin paditës shumën prej 250,00 euro), si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata me aktvendimin C.nr.101/2021 të datës 23.09.2022, ka obliguar të paditurën që të përgjigjet në padi, të cilin aktvendim e ka pranuar me datë 03.10.2022, ndërsa përgjigjen në padi e ka paraqitur me datë 10.10.2022.

Në përgjigjen në padi e paditura ndër të tjera ka deklaruar se padia dhe kërkesëpadia e paditësve është parashkruar pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit është nënshkruar më 18.04.2017 ndërsa paditësit e kanë paraqitur padinë në gjykatë me datë 19.02.2021, ndërsa Kontrata Kolektive e Arsimit është me efekt veprimi deri më 18.04.2020, dhe se e njëjta nuk ka efekt për asnjë kërkesë e cila lind pas kësaj date. Gjithashtu gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta hudhë poshtë si të palejuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palës nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit merititor.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura në padi dhe në përgjigjen në padi, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestuese se paditësit kanë themeluar marrëdhënie pune me të paditurën, fakt ky që konstatohet edhe me kontratat e punës dhe atë për paditësin e parë I.I. kontrata e punës me numër 47/20, e datës 18.01.2018, për paditësen e dytë R. B. kontrata e punës me numër 47/20, e datës 03.05.2019, si dhe për paditësen e tretë N. M. kontrata e punës me numër 275/20, e datës

06.12.2018. Kontestuese nuk ishte po ashtu rrethana se e paditura K, e V, nuk ka bërë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punë.

Kontesutese ishte parashkrimi i kërkesës së paditësve.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, andaj duke ju referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, me të cilin përcaktohet se *“kreditore në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, e lidhur me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, si dhe të datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore”*, si dhe vërtetimet e lëshuara nga SHFMU “N. Zh,” fshati S. i P., komuna V., për paditësit I.I., R. B. dhe N. M. të gjithë nga V, të datës 28.10.2020, për periudhën nga data 01.09.2019 e deri më 11.03.2020, erdhi në përfundim se kërkesa e paditësve është e bazuar, andaj edhe u’u njohu shumën prej 250,00 euro për secilin paditës, në shumë totale prej 750,00 euro, duke përlllogaritur një ditë pune me 2,00 euro ($125 \times 2 = 250$).

Kundërshtimin e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit, gjykata e vlerësoj si të pa bazuar pasi që në Ligjin e Punës, përkatësisht në nenin 87 të tij është përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, ndërsa paditësit kërkesën e tyre e kanë parashtruar për periudhën nga data 01.09.2019 deri më 11.03.2020, që përfshinë periudhën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017, ndërsa padinë e kanë paraqitur në gjykatë më 19.02.2021.

Gjykata përveç kërkesës kryesore paditësit ua njohu edhe të drejtën në kamatë në lartësi prej 8% në vit, duke llogaritur nga data e pranimit të aktgjykimit, e deri në pagesën definitive, duke u

bazuar në kërkesën e paditësve si në petitumin e padisë, e konform nenit 382 par.2 të LMD-së dhe nenit 2 par. 1 të LPK-së, duke vendosur vetëm brenda kërkesës së palëve.

Gjykata vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi për shpenzimet e procedurës, bazuar në nenin 452 të LPK-së, duke i' a njohur paditësve shumën prej 228,00 euro, shpenzime këto të cilat i'u referohen shpenzimeve për pagesën e taksës për padi në shumë prej 20,00 euro, si dhe për përpilimin e padisë shumën prej 208,00 euro.

Bazuar në të lartcekurat, e në kuptim të nenit 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Vushtrri-
Departamenti i Përgjithshëm për Çështje Civile
C.nr.101/2021, datë 18.10.2022

Gj y q t a r i
Naim Rekaliu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.